

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mahir Tutuli, kryetar i kolegjit, Rafet Haxhaj dhe Qerim Ademaj, anëtarë në çështjen juridike të paditësit Kompania e Sigurimeve “AXA Ëinterthur”, General-Guisan Strasse 40, CH 8401 Ëinterthur-Zvicër, të cilën me autorizim e përfaqëson “ICS Assistance” L.L.C nga Prishtina, gjegjësisht B.N., kundër të paditurave “Eurosig” me seli në Tiranë, Rr. ”Papa Gjon Pali II” dhe BKS-Byroja Kosovare e Sigurimeve, me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të demit, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, C.nr.169/2013, të datës 11.12.2015, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 10.10.2017, mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e të paditurës BKS-Byroja Kosovare e Sigurimit, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, C.nr.169/2013, të datës 11.12.2015, **VËRTETOHET**.

### **A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar, në paragrafin I të dispozitivit, e ka miratuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit Kompania e Sigurimeve “AXA Ëinterthur”, General-Guisan sur.40, Ëinterthur-Zvicër, ashtu që i ka detyruar të paditurat që në mënyrë solidare në emër të kompensimit të demit nga baza e sigurimit auto kasko, nga rasti i siguruar i datës 13.08.2011, paditësit t’ia paguajnë shumën prej 8.997,00€, me kamatë ndëshkuese prej 12%, duke llogaritur nga data 29.12.2011 e deri në pagesën definitive, brenda 7 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit, ndërsa në paragrafin II të dispozitivit, ka detyruar të paditurat që në emër të kompensimit të shpenzimeve të procedurës kontestimore, paditësit t’ia paguajnë shumën e përgjithshme prej 1.826,62€, pas pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë e paditura e “BKS-Byroja Kosovare e Sigurimit, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë ta refuzojë në raport me të paditurën e dytë, apo ta prish dhe lëndën ta kthejë të njëjtës gjykatë në rigjykim.

Përgjigje në ankesë nuk ka.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës , aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK , gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar.**

Paditësi Kompania e Sigurimeve “AXA Winterthur”, General-Guisan sur.40, Winterthur-Zvicër, të cilën e përfaqëson “ICS Assistance” L.L.C nga Prishtina, gjegjësisht B.N., me datën 08.04.2013, pranë gjykatës së shkallës së parë ka parashtruar padi kundër të paditurave “Eurosig” me seli në Tiranë dhe BKS-Byroja Kosovare e Sigurimit, me seli në Prishtinë, për kompensimin e dëmit regres të pësuar nga aksidenti i trafikut, i datës 13.08.2011, për çka ka kërkuar nga gjykata që të paditurat t’ia paguajnë shumën e përgjithshme prej 9.194,21 euro me kamatë ndëshkuese prej 20%, duke filluar nga data 21.10.2010 e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës. Në fjalën përfundimtare, përfaqësuesi i palës paditëse e ka bërë riprecizimin e kërkesëpadisë në kuptim të gjetjes nga ekspertiza lidhur me lartësinë e dëmit, në shumën prej 8.997,00€, me kamatën për vonesë sipas normës prej 12%.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit meqenëse e paditura e dytë nuk e ka kundërshtuar bazën juridike të kërkesëpadisë, por vetëm lartësinë e kompensimit të kërkuar. Gjykata e shkallës së parë vlerësimin e vet e ka mbështetur në konstatimin e ekspertit të makinerisë, për vlerësimin e dëmit Nexhmi Shala, të dhënë në ekspertizën teknike të datës 06.04.2015, sipas të cilit ka rezultuar se automjeti i siguruar me kasko sigurim është dëmtuar nga aksidenti i komunikacionit i datës 13.08.2011 dhe se lartësia e dëmit të shkaktuar është në shumën prej 8.997,00 €, vlerësim ky i mbështetur në vlerën e pjesëve të dëmtuara.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale respektivisht nenin 154 pika 1 të dhe 939 të LMD-së, për shkak se nga shkresat e lëndës dhe nga thëniet e palëve, rezulton se përgjegjës për dëmin e shkaktuar ka qenë i siguruari i të paditurës “Eurosig” me seli në Tiranë, me ç’ rast paditësi ia ka paguar të siguarit të tij kompensimin e dëmit të pësuar dhe me pagimin e kompensimit të gjitha të drejtat e të siguarit kanë kaluar të paditësi. Po ashtu gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë i ka zbatuar dispozitat e nenit 26 pika 6, të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, i cili përcakton lartësinë e kamatës prej 12% nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim. Në rastin konkret, paditësi ka parashtruar pranë të paditurës “Eurosig” me seli në Tiranë, kërkesën për kompensim me datë

29.12.2011, dhe sipas dispozitës së cekur kamata rrjedh nga kjo datë, andaj gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale.

Gjykata e Apelit i shqyrtoj pretendimet ankimore se të paditurës “BKS-Byroja Kosovare e Sigurimeve i mungon legjitimiteti pasiv, por gjeti se janë të pabazuara ngase me nenin 6.4 të Memorandumit të Mirëkuptimit (MOU) i datës 11.10.2006 i arritur në mese të Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës si entitet i autorizuar nga Misioni i Administratës së Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovës dhe Byrosë Shqiptare të Sigurimit-Tiranë lidhur me Njohjen e dyanshme të Certifikatave të Sigurimit të detyruar të Autopërgjegjesisë dhe të palës së tretë si vërtetim për sigurimin e detyrueshëm TPL dhe procedurat për trajtimin, pagesën dhe kompensimin e sigurimeve të detyrueshëm të dëmeve TPL, është përcaktuar që *“në rast të daljes në gjyq palët pajtohen dhe pranojnë “ligjmëri pasive” solidare të Anëtarëve Sigurues dhe Byrosë së Pagesave”*, nga çka rrjedh se në këtë rast e paditura BKS-Byroja Kosovare e Sigurimeve si Byro e Pagesave, ka legjitimitet pasiv për të qenë palë në procedurë në këtë çështje juridike.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të të paditurës, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë e ka zbatuar të ligjin material, ndërsa pretendimet e të paditurës janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërshtim me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata e Apelit.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK .

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS ,**  
**Ae.nr.29/2016,dt.10.10.2017**

**KRYETARI I KOLEGJIT,**  
**Mahir Tutuli,d.v.**